



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6083 Prot.

Lezhë, më 06 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 73 Datë 30 . 03 . 2021

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga permbytja të banesës së shtetasit Alban Preknica, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligji Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Alban Preknica, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Alban Preknica për dëmtimin e banesës së tij nga permbytja.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga permbytja në vlerën 78000 lekë.

a) Demi i shkaktuar në ndertese 0 lekë.

b) Demi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 78000 lekë.

B. Mbështetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gerrat b e ç, Kompensimi per demin e shkaktuar ne anen ndertimore te jete ne masen 50%, ndersa Kompensimi per demin e shkaktuar ne orendi, mobilje e pajisje, mbeshtetur ne kap 3, pika 3, germa d, te VKM-së së mesiperme te jete sa masa e demit te shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e Kompensimit të demit në anen ndertimore të jetë 0 lekë.

b) Vlera e Kompensimit të demit në orendi, mobilje e pajisje 78000 lekë.

Vlera totale 78000 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.
3. Bashkia Lezhe ti akordojë familjes së shtetasit Z.Alban Preknicaj me Nr.ID.H70415048J ndihmen emergjente në vlerën prej 78000 (shtatedhjetë e tete mije) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkisë për vitin 2021, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012.
4. Ndihma financiare që do ti akordohet do të përdoret për të ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z.Alban Preknicaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga permbytja.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

